



Pranuar / Dorezuar Përmblenë/Prodato Received/Delivery	13.06.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicana Quantity
SKIMSHUK	4732/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.752/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga:Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.752/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesime adresëkomuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 13.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Pjesërisht si e bazuar ankesa me A.nr.752/2023 e datës 18.05.2023 e parashtruar nga ankuesi.
- II. Detyrohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 08.02.2023, të parashtruar nga ankuesi Behar Mjeku.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Lipjanit, me datë 18.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me arsyetimin se i takon shtesa për vëllim të punës bazuar në Vendimin e datës 26.01.2023 të Zyrtarit Kryesor Administrativ të Komunës së Lipjanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit, ndërsa kjo e fundit më datë 25.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4324/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 08.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në organin e punësimit; Kërkesën për përgjigjeje në ankesë të datës 23.05.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 25.05.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 24.04.2023 nga Udhëheqësi i Personelit; Akt emërimin e ankuesit të datës 01.04.2011; Listën e pagave për muajin prill-2023; Listën e pagave për muajin mars-2023; Listën e pagave për muajin tetor-2023; Listën e pagave për muajin tetor-2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se është pjesërisht i bazuar pretendimi ankimor i ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhe se ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit dhe se i njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 01.04.2011 mbanë pozitën e punës Inspektor i Trafikut në Drejtorin e Inspektionit. Me vendimin të datës 26.01.2023 të Zyrtarit Kryesor Administrativ përkatësisht kryetarit të Komunës së Lipjanit, caktohet menaxher i kontratës për Mirëmbajtje dhe pastrim të rrugëve dhe trotuareve gjate sezonit të dimrit tri lloto në disa pjesë të komunës së Lipjanit .

Ankuesi me datë 08.02.2023 parashtron kërkesë te organi i punësimit për kompensimin e shtesës në pagë për shkak të përgjegjësi dhe detyrave shtesë të deleguara përkatësisht vëllimit të punës sipas Vendimit të datës 26.01.2023.

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës duke pretenduar se i takon e drejta e kompensimit për detyra dhe përgjegjësi shtesë respektivisht vëllim të punës e i cili pretendim bazohet në nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat e të Punësuarve në Sektorin Publikë të datës 06.02.2023. Ankuesi deklaron se nuk ka marr përgjigjeje nga organi punësimit konkretisht Udhëheqësi i Personelit edhe përkundër kërkesës së nr.01-400/01-7247 të datës 08.02.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik e cila dispozitë përcakton: "Se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji..." Ndërlidhur me këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative ka përcaktuar se: "Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë së i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik", sipas këtyre dispozitave ligjore rezultojnë se çdo nëpunës civil i cili pretendon se i është cenuar ndonjë e drejtë nga një veprim administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) të organit gjegjes të punësimit, ka të drejtë të parashtrij ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht nenit 98 me të cilin është përcaktuar se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj...*", si dhe nenit 127 paragrafi 4 me të cilin parashihet se: 4. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrijet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ".* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit Behar Mjeku në Këshill është e pranueshme dhe se pretendimet ankimore të tij lidhur me heshtjen administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e datës 08.02.2023 janë të bazuara.

Andaj, përkitazi me kërkesën e ankuesit të datës 08.02.2023, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës nuk ka gjetur dëshmi se Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit është përgjigjur në kërkesën e ankuesit, përveç që në përgjigje në ankesë Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 24.05.2023 ka deklaruar se janë të gatshëm të bëjnë kompensimin e palës ankuese për pagesat shtesë sipas Vendimit të datës 26.01.2023, mirëpo nuk është nxjerrë ndonjë akt administrativë sa i përket kësaj çështje dhe që i është adresuar ankuesit.

Kështu që bazuar në nenin 97 paragrafin në Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 1 ku parashihet se: *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ....*, Kolegji vlerëson se organi i punësimit përkatësisht Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit duhet të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 08.02.2023 dhe në lidhje me kërkesën të nxjerrë akt administrativë bazuar në pretendimin ankimor të ankuesit e në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore, dhe mbi këtë bazë edhe është aprovuar pjesërisht ankesa si në pikën I të këtij vendimi vetëm sa i përket trajtimit të kërkesës, ndërsa vendimmarrje sipas aktit administrativë duhet të jetë në harmoni me legjislacionin që rregullon këtë çështje që ndërlidhet me pretendimin ankimor të ankuesit.

Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për



Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.752/2023, datë 13/06/2023

Vjollca SINANI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

